



Prishtinë, 12 nëntor 2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1305\_2020

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin në parcelën ngastrada kadastrave Nr. 772-17 ZK Çagllavicë me kapacitet të instaluar prej 8 kW në Komunën e Prishtinës, të datës 09.10.2020 me nr. prot. 616/20 të aplikuesit personit fizik Gjeloš Berisha, me adresë: Rr. "Marko Boçari" Komuna Prishtinës, Republika e Kosovës.

**në seancën e mbajtur më 12 nëntor 2020 nxori këtë:**

## **V E N D I M**

### **PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM**

- I. **APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit personit fizik Gjeloš Berisha për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin në parcelën ngastrada kadastrave Nr. 772-17 ZK Çagllavicë me kapacitet të instaluar prej 8 kW në Komunën e Prishtinës.
- II. **OBLIGOHET** – aplikuesi personi fizik Gjeloš Berisha me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPR- 90148071 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrorj kërkesë në KEDS SH.A., për pranimit teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi personi fizik Gjeloš Berisha do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.




## Arsyetim

- ZRRE, me datë 09.10.2020 nga aplikuesi personi fizik Gjeloš Berisha, ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin në parcelën ngastrada kadastrave Nr. 772-17 ZK Çagllavicë me kapacitet të instaluar prej 8 kW në Komunën e Prishtinës.
  - Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergetik Nr. 8063 të datës 09.10.2020 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Vendimin Nr. 05-353/02-125661/20 dt. 03.09.2020 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit, Komunës së Prishtinës.
  - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit personit fizik Gjeloš Berisha dhe dëshmimeve të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin në parcelën ngastrada kadastrave Nr. 772-17 ZK Çagllavicë me kapacitet të instaluar prej 8 kW në Komunën e Prishtinës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
Besim Sejfiqaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar



**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Prishtinës,
- KEDS SH.A., dhe
- Arkivit të ZRRE-së.